



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.973/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Internews Kosova, me seli ne rr. Afrim Zhitia nr. 7, Prishtinë, ndaj debitorit Radio Televizioni i Kosovës më seli ne Prishtinë, bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr.1332/2022 të datës 31.05.2023, me datën 28.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Internews Kosova, me seli ne rr. Afrim Zhitia nr. 7, Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr.1332/2022 të datës 31.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.165/21 të datës 25.02.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar te anulohet, te refuzohet prapësimi i debitorit dhe te mbetet ne fuqi urdhri përmbartimor nr.165/21 të datës 25.02.2022, ose çështja te kthehet ne rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në baze të faturave të listuara në aktvendimin e ankimuar dhe propozimin për Urdhër përmbarrimor. Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor nr.165/21 të datës 25.02.2022, i ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga faturat t'i paguaj shumën 25,000.00€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim me pretendimin që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarrimor.

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkalles së parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se faturat mbi bazën e se cilave është lejuar përmbarrimi nuk janë pranuar nga debitori, të njëjtat fatura nuk janë nënshkruar nga personi-subjekti në emër dhe mbiemër dhe si të tilla nuk përbejnë bazë për përmbarrim, ndërsa kreditori nuk ka mundur të argumentoj pretendimet e tij me asnjë provë me të cilin se faturat i janë dorëzuar debitorit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk kanë qenë e nënshkruar nga pranuesi i faturës, e që në këtë rast nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Neni 29 par.1 nënpar.1.1 përcakton se: “ 1. Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1 kambialet dhe çequet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës”. Në këtë rast e rëndësishme është që të vërtetohet se a është pranuar fatura nga ana e debitorit, pra e njëjta a është nënshkruar sepse kjo nënkupton se debitori i ka pranuar detyrimet e tij që i ka ndaj kreditorit.

Gjykata e shkalles së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Gjykata e shkalles së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 Për Zbatimin E Ligjit Nr. 03/L-222 Mbi Administratën Tatimore Dhe Procedurat, i cili në nenin 20 par.1 nënpar.1.17 parasheh që “Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”, andaj,

faturat si dokumente ne sajë te cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga debitori, te njëjta nuk janë te vulosura e as nënshkruar nga debitori ne mënyrë qe te konsiderohen si dokumente te besueshme, ndërsa vlerëson se me te drejt gjykata e shkalles se parë ka vlerësuar se kreditori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme ne mbështetje te pretendimeve te tij.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.973/23, me datë 28.08.2023

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi